

FJALA E DEPUTETIT VANGJEL DULE

E ENJTE 21 KORRIK 2022

Të nderuar kolegë,

E nderuara Kryetare,

Fillimisht dëshiroj të shpreh vlerësim dhe mbështetje si për raportimin, ashtu edhe për të gjithë aktivitetin e institucionit, por edhe të kryesueses së Avokatit të Popullit gjatë mandatit të kaluar. Në të njëjtën kohë, dua të shpreh edhe angazhimin tim si personalisht, ashtu edhe si parti, që do të jemi mbështetës në vazhdimësi të këtij institucioni nevralgjik për fatet e funksionimit të shtetit të së drejtës dhe të demokracisë në vendin tonë. Natyrisht, do ta konsideroja luks të vazhdoja më tepër në lidhje me Avokatin e Popullit, në një kohë kur kemi çështje të tjera jashtëzakonisht të rëndësishme dhe shqetësuese në aktualitetin politik.

Vendi ynë mori atë që prej shumë e shumë vitesh përbënte ëndrrën e mbarë shoqërisë dhe të gjithë qytetarëve. Fakti që rastis të jemi ne në sallën e organit legjislativ, përbën edhe një vlerësim dhe meritojnë një përgëzim të gjithë anëtarët e Kuvendit. E theksoj për të gjithë, sepse po ndodh ajo që pritej të ndodhte, por në asnjë rast nuk duhej të ndodhte, protagonizmi. Në krye të gjithçkaje në vendin tonë, që ka kryemeritën, sipas tij, për çeljen e negociatave me Bashkimin Europian për anëtarësimin, emri i të cilit është i gdhendur në 9 vjetët e dështimit të zhvillimit të Konferencës së Parë Ndërqeveritare, është Edi Rama, i cili pretendon se ka kryemeritën për zhvillimin e dy ditëve të fundit. Jo, zotërinj!

Zhvillimi i Konferencës së Parë Ndërqeveritare është thjesht dhe vetëm ai që ka qenë gjithmonë: vullneti i Bashkimit Europian në tërësi dhe i vendeve anëtare të tij për ta përfshirë vendin tonë në familjen europiane. Nuk është aspak meritë e kësaj qeverie, as e parlamentit dhe nuk janë zhvillime të atilla që të justifikojnë si zhvillimin e konferencës, ashtu edhe çeljen e negociatave, kapitull më kapitull. Prandaj, në vend që të nxitojmë të rrëmbejmë topin dhe ta mbajmë për vete, është momenti i një reflektimi të thellë dhe të gjithanshëm. Sfida që kemi përpara, është një golgotë e shumanshme, dimensionale, që kërkon impenjimin e të gjithëve,

kërkon shfrytëzimin e resurseve të të gjithë shoqërisë, kërkon angazhimin e ekspertizës më të mirë që ka vendi dhe shoqëria brenda vendit, por edhe ata që janë në emigracion.

Më lejoni që me një parafrazim dhe me një metaforë të bëj një adoptim të një vargu se çfarë është Bashkimi European dhe se si mund të qëndrosh me meritë në atë. Është një varg nga poeti Kavafis, i cili thotë: “Që me meritën tënde të jesh qytetar në qytetin e ideve është shumë e vështirë dhe në atë qytet rrallë të japin qytetarinë. Në agoranë e saj gjen ligjvënës që asnjë aventurier nuk mund t’i hedhë”. Çfarë është Bashkimi European? Bashkimi European është familja e katër lirive: e lirisë së shprehjes, e lirisë së besimit, e lirisë nga nevoja dhe e lirisë nga frika, por, në të njëjtën kohë, është familja e votës së lirë kur ne jemi vendi ku blihet dhe vidhet vota. Bashkimi European është vendi i respektimit të të dhënave personale, ndërsa ne jemi vendi i patronazhistëve dhe i kryepatronazhistit, që pretendon Kryeministri.

Bashkimi European është vendi i lirisë së besimit, ndërsa ne jemi vendi që komuniteteve fetare u grabisim pronat. Bashkimi European është vendi i respektimit të të drejtave të minoriteteve, kurse ne jemi vendi që i ndajmë në të mirë dhe në të këqij, që i asimilojmë, në vend që t’i integrojmë. Prandaj, zonja dhe zotërinj, ai flamur që u ngrit dje, duhej të ishte ngritur këtu. Ai flamur nuk është i asnjë Kryeministri, nuk është i asnjë ministri, por është i kësaj shoqërie, është i këtij vendi dhe aty ku përfaqësohet ai, është Kuvendi dhe nuk është qeveria private e Edi Ramës dhe e sektit të tij. Faleminderit!